

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA** si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja individuale Suzana Çerkini me sekretaren juridike Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.U.nga P., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.906/2015 të datës 08.06.2016, pas seancës fillestare, të hapur për publikun të mbajtur më datë 30.07.2018 në praninë e Prokurorit të shtetit Besa Limani dhe të pandehurit Sh.U., të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

**I pandehuri Sh.U.**, nga i ati U. dhe nena Xh., e vajzërisë H., i lindur me ... në B., jeton në P. në vendbanim në rrugën "A." nr...., i martuar baba i ... fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Rrepublikës së Kosovës, gjendet në vuatje të dënimit në një qështje tjetër penale,

### Ë S H T Ë F A J T O R

**Sepse**, gjatë periudhës kohore të pavërtetuar ka mbajtur në posedim armë në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armë të tilla, ashtu që me datë 12.11.2015 rreth orës 10:30 në P. në lagjen "K. e D." gjatë arrestimit të tij nga ana e policisë i është gjetur dhe sekuestruar në shtëpinë e tij revolva e kalibrit 9mm me nr serik L-92942,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe neneve 248, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

### D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumë prej **650 (gjashtëqindpesëdhjetë euro)**, të cilin dënim obligohet t'a paguajë jo më gjatë se tre muaj pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë,

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet komfor nenit 46 të KPRK, gjykata këtë dënim me gjobë do t'ia shëndrrojë në dënim me burg duke llogaritur 20 euro për një ditë burgim, si dhe,

### **DËNIM PLOTËSUES**

Konfiskohet: një revole 9 mm me nr serik L-92942, një karikator, dhe 7 fishekë te kalibrit 9 mm, ne baze te vërtetimit mbi marrjen e përkohshme te sendeve me nr të rastit të hetimeve 2015-DKR-36 te datës 12.11.2015,

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat jo më gjatë se 3 muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.906/2015 të datës 08.06.2016 ka akuzuar Sh.U., për veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti seancë të shqyrtimit fillestar në të cilin i pandehuri Sh.U., duke u vënë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, meqë i pandehuri ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi është në përputhje të plotë me provat nga shkresat e lëndës, andaj mbi këtë bazë i propozoi gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilën do ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe pas pajtimit të prokurorit të shtetit, gjykata gjithashtu aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, duke vlerësuar se pranimi është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe të vullnetshme ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës dhe se, aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike.

Gjykata, pas aprovimit të pranimit të fajësisë së të pandehurit dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit si, rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri është kryes i veprave penale serioze për të cilat tani më është duke vuajtur dënimin në kohëzgjatje prej 15 vjetësh, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim me gjobë, siç është e precizuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale të kësaj natyre dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, gjykata e mori në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.353/16, me datë 30.07.2018.**

**Zyrtare ligjore**  
**Albulena Ademi**

---

**Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare**  
**Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.